



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT
(Përfundimtar)

PËR

**MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT
CIVIL**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE
PËR FONDET E BE-së, BB-së DHE DONATORËVE TË TJERË**

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë, Maj 2019

RAPORT

Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes dhe të Vendimit nr. 32, datë 19.4.2019, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë”*, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, Tiranë.

Drejtorja e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, është institucion i krijuar me Vendimin nr. 299, datë 23.5.2018, të Këshillit të Ministrave, *“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë”*, ku në pikën 1 të tijështë përcaktuar se është person juridik publik, që financohet nga buxheti i shtetit, në varësi të ministrit përgjegjës për financat, me seli në Tiranë.

Sipas këtij vendimi, Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, është organizuar në nivel qendror dhe e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me mision sigurimin e një menaxhimi efektiv, financiar dhe teknik të projekteve të miratuara sipas marrëveshjeve financiare me Komisionin Europian, Bankën Botërore dhe donatorë të tjerë.

Ky institucion, pavarësisht datës që mban vendimi për krijimin e tij, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr.8549/1999, *“Statusi i nëpunësit civil”*, pasi ka qenënjësi organizative, brenda strukturës së Ministrisë së Financave.

Hyrja në fuqi i Ligjit nr. 152/2013, *"Për shërbimin civil"*, i ndryshuar, në fushën e veprimt të tij, ndër institucionet e tjera ka përfshirë edhe ministrinë si pjesë e institucioneve të administratës shtetërore. Vendimi nr. 142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave, *"Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura"*, në lidhjen 1 bashkëlidhur tij, në *"Listën e institucioneve të administratës shtetërore"* parashikon në mënyrë të shprehur *"aparartet e ministrive"* si pjesë e institucioneve të administratës shtetërore, ndaj të cilave zbatohet ligji për nëpunësin civil; për pasojë edhe Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, duke qenë se vazhdon të jetë pjesë e strukturës organizative të Ministrisë së Financave, është pjesë e skemës së shërbimit civil.

Kjo do të thotë që, për të gjithë punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, zbatohet ligji nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, të ndryshuar, duke filluar që nga momenti i rekrutimit, pra, pranimi në shërbimin civil dhe duke vazhduar me të gjitha procedurat që ndiqen gjatë aplikimit të instituteve të ligjit.

Evidentojmë faktin se edhe në Vendimin nr. 299, datë 23.5.2018, të Këshillit të Ministrave, që është akti mbi të cilin kjo drejtori shkëputet nga Ministria e Financave dhe u krijua si institucion në varësi të saj, në pikën 10 të tij, përcaktohet se:

"Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil..."

Procesi i mbikëqyrjes në këtë institucion, filloi në datën 23.4.2019, në zbatim të Programit të Mbikëqyrjes nr. 433/1 prot., datë 19.4.2019, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar institucionit me shkresën nr.433/2 prot., datë 19.4.2019, *"Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë."*

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil, gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, i përbërë nga inspektorët Valentina Kolleshidhe Aida Dobjani, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në

institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë.

Ky material, me shkresën nr. 433/5 prot., datë 27.5.2019, u dërgua për njohje, pranë institucionit, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet e tyre në lidhje me gjetjet e grupit të punës. Projektraporti i mbikëqyrjes, me shkresën nr. 433/6 prot., datë 27.5.2019, i është dërguar për njohje, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, që është ministria nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur, si dhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur, me shkresën nr.433/7 prot., datë 27.5.2019.

Subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 10205/1 prot., datë 31.5.2019, ka dërguar të nënshkruar projektraportin pa vërejtje, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes.

Oëllimi i mbikëqyrjes

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:

- Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion.
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit Civil*”, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit.
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune.
 - Rastet e refuzimit të deklaramit të statusit të punësimit.
 - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklaramit të statusit të punësimit të punonjësve.
 - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklaramit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
- Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).

7. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).
8. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.
9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (*kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të Përhershëm*).
10. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar. Si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë periudhës së vlerësimit (*Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues*).
11. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
12. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (*njësia përgjegjëse*), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Metodologjia e mbikëqyrjes

Grupi i punës ka zgjedhur si metodë pune verifikimin e dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit dhe në arkivën e institucionit, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Si fillim grupi i punës bëri një takim me personin e kontaktit, *****. Kjo nëpunëse mban pozicionin, “*Përgjegjëse sektori*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, e cila kryen edhe detyrën e administrimit të burimeve njerëzore për Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktive për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë. Kjo për faktin se ky institucion, nuk ka të planifikuar në strukturën e tij, pozicion pune për menaxhimin e burimeve njerëzore.

- U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës, për institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë.
- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe përmbajtja e dosjeve individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.
- U verifikuan përshkrimet e punës për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, nëse ato janë të hartuara në përputhje me formatin standard të miratuar.
- U verifikuan formularët e vlerësimit të punës në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civilë të institucionit dhe, nëse ky proces, është kryer sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës, të çdo nëpunësi, për të provuar përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës, si arsimi, përvoja në punë e të tjera.

Konstatimet janë të materializuara si tabela më vete (*Tabela 1 dhe Tabela 2*), të cilat janë pjesë e këtij projektraporti.

- I. **Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.**

1. **Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes.**

Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka funksionuar mbi bazën e strukturës së Ministrisë së Financave, pasi ishte njësi organizative brenda kësaj ministrie.

Po kështu, edhe me ndryshimin e strukturës me Urdhrin nr. 161, datë 5.10.2017, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, kjo drejtori i është nënshtruar procesit të ristrukturimit si njësi organizative brenda ministrisë. Numri i pozicioneve të punës është gjithsej **34 pozicione, të gjitha pjesë e shërbimit civil.**

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, paraqitet si institucionë varësi të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, i cili është krijuar me Vendimin nr. 299, datë 23.5.2018, të Këshillit të Ministrave dhe mbi bazën e tij, me Urdhrin nr. 88, datë 13.6.2018, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë”, është miratuar struktura organizative e institucionit.

Sipas kësaj strukture, institucioni, ka ruajtur numrin e përgjithshëm të vendeve të punës, gjithsej **34** pozicione, të cilat vazhdojnë të jenë pjesë e shërbimit civil, por, ka sjellë ndryshime në mënyrën e organizimit të 2 drejtorive dhe sektorëve.

Klasifikimi i pozicioneve në shërbimin civil, është bërë mbi bazën e përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar me Vendimin nr. 262, datë 25.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ku, për çdo pozicion pune, është mbajtur parasysh natyra e pozicionit sipas specifikave të tij, si dhe përshkrimi i punës.

Në rastin konkret, 34 pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, paraqiten në këtë raport:

- Nëpunës civilë të nivelit të lartëdrejtues, TND, është **1** pozicion pune, ose rreth **3%** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, i cili i përket pozicionit “Drejtor i Përgjithshëm”.
- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, janë **2** pozicione pune, ose rreth **6 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor”.
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, janë **7** pozicione pune, ose rreth **20.5 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, i cili i përket pozicionit “Përgjegjës Sektor”.

- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **24** pozicione pune, ose **70.5 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “*Specialist*”.

Nisur nga përmbajtja e strukturës, konstatohet se, ajo është e organizuar duke u mbështetur në strukturën organizative hierarkike, të përcaktuar në ligjin nr. 90/2012, “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*”, Kreu III, “*Organizimi i brendshëm i institucioneve të administratës shtetërore*”, Seksioni 2 “*Institucionet e varësisë*”, ku përcaktohet organizimi i brendshëm i institucioneve të varësisë.

Në rastin konkret, Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, është e organizuar në nivelin e drejtorisë së përgjithshme, që drejtohet dhe përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Ky nivel organizimi, është përcaktuar në Vendimin nr. 299, datë 23.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë.*”

Në përmbajtje të saj, struktura është e përbërë nga 2 drejtori dhe 7 sektorë:

- Drejtoria për Menaxhimin e Projekteve IPA, e cila ka në përbërjen e saj pesë sektorë: Sektori i Përgatitjes dhe Zbatimit të Projekteve; Sektori i Vlerësimit dhe Kontraktimit; Sektori i Menaxhimit Financiar; Sektori i Kontrollit të Nivelit të Parë (FLC); si dhe Sektori i Sigurimit të Cilësisë dhe Kontrollit.
- Drejtoria për Zbatimin e Projekteve të Bankës Botërore dhe Donatorëve, e cila ka në përbërjen e saj dy sektorë: Sektori i Menaxhimit të Prokurimeve dhe Sektori i Menaxhimit Financiar.

Çmohet se, përcaktimi i pozicioneve të punës, si pjesë e shërbimit civil, është bërë në përputhje me pikën 2 dhe 3, të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të ndryshuar.

Evidentojmë faktin se, struktura nuk ka të parashikuar pozicion pune për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Bazuar në Urdhrin nr. 213, datë 30.7.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “*Mbi funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të*

tjerë, si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë”, këto detyra i kryen Sektori i Burimeve Njerëzore, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Mos pasja e një pozicioni për menaxhimin e burimeve njerëzore, në strukturë, është kryer duke përdorur si mbështetje ligjore Vendimin nr. 893, datë 17.12.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”.

Por, nga ana tjetër, ky vendim, e parashikon delegimin e detyrave për menaxhimin e burimeve njerëzore, në varësi të madhësisë së institucionit. Në rastin konkret, në pikën 28 të tij, përcaktohet se, “në institucionet, që kanë të paktën 30 (tridhjetë) pozicione pune, duhet të ekzistojë një pozicion pune për menaxhimin e burimeve njerëzore”.

Po kështu, ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në nenin 10 të tij, parashikon krijimin e njësisë së burimeve njerëzore, në çdo institucion në fushën e veprimit tëshërbimit civil, duke e konsideruar atë përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit dhe në administrimin e shërbimit civil.

Nga sa më sipër, si dhe duke patur parasysh numrin e pozicioneve të punës në strukturë, që aktualisht janë 34 pozicione pune, nga ana e institucionit dhe Departamentit të Administratës Publike, duhet të shihet mundësia e përfshirjes në strukturën organizative në të ardhmen, edhe të një pozicioni pune për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Konstatohet se, institucioni funksionon mbi bazën e rregullores së miratuar me Urdhrin nr.17, datë 29.1.2016, të Ministrit të Financave, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Ministrisë së Financave”. Grupi i punës u informua se po punohet për hartimin e rregullores së re të Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, projekti i së cilës akoma nuk ka përfunduar.

Në këto kushte, duke qenë se rregullorja e brendshme është në proces hartimi, rekomandojmë që ky akt i rëndësishëm, të evidentojë detyrat kryesore që duhet të përmbushë secili pozicion pune, sipas strukturës dhe organikës së institucionit, në përputhje edhe me parimet dhe rregullat e ligjit për nëpunësin civil.

Konkluzion: Nga sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, struktura organizative e institucionit të mbikëqyrur, në përmbajtje të saj, prezanton nivelin e nëpunësisë, nëpunësit civilë në përputhje me funksionet administrative për të cilin është krijuar institucioni. Kjo

strukturë, është e organizuar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, në lidhje me organizimin e brendshëm të institucioneve të varësisë.

Numri i punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, është brenda kufirit të miratuar.

Ndërkohë, institucioni i mbikëqyrur, në bashkëpunim me njësinë e burimeve njerëzore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Departamentin e Administratës Publike, në momentin e rishikimit të strukturës, duhet të parashikojnë në këtë strukturë, një pozicion pune për tu kujdesur për veprimet e përditshme të burimeve njerëzore të institucionit.

2. Mënyra e plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil në momentin e realizimit të mbikëqyrjes.

Ashtu si jemi shprehur edhe më sipër në material, në momentin e ristrukturimit të Ministrive, Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, si pjesë përbërëse e strukturës organizative të Ministrisë së Financave, i është nënshtruar procesit të ristrukturimit dhe për pasojë ka qenë objekt i kontrollit nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili në fund të verifikimit tëgjithë procesit, në lidhje me gjetjet, është shprehur nëpërmjet raportit “Për monitorimin e procesit të ristrukturimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”.

Për sa më sipër, objekt i kësaj mbikëqyrjeje është verifikimi i mënyrës së plotësimit të pozicioneve tëpunës pjesë e shërbimit civil, nga momenti i ristrukturimit të kryer në vitin 2017 dhe deri në momentin e mbikëqyrjes.

Nga kontrolli i ushtruar, si dhe nga materialet që na janë vënë në dispozicion nga njësia e menaxhimit tëburimeve njerëzore, mënyra e plotësimit të **34 pozicioneve** të punës, të gjitha pjesë e shërbimit civil, në administratën e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, **në momentin e realizimit të mbikëqyrjes**, paraqitet si më poshtë:

- **22 pozicione pune**, që zënë rreth **64.8%** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë të plotësuara nga nëpunës civilë të konfirmuar, që njësia përgjegjëse, DAP, me ristrukturimin e ministrisë, viti 2017, i ka sistemuar në këtë drejtori dhe vazhdojnë marrëdhënien e punësimit po në këtë drejtori edhe në momentin e mbikëqyrjes.

Në këtë grup punonjësish, konstatohet se, në **1 rast**, nëpunësi ka kryer ngritje në detyrë, për pozicionin e punës, “Përgjegjës sektori”, brenda institucionit, nëpërmjet konkurrimit të zhvilluar nga njësia përgjegjëse (DAP), në përputhje me procedurat e përcaktuara nga ligji nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

- **7 pozicione pune**, që zënë rreth **20.5 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar nëpërmjet konkurrimit të zhvilluar nga njësia përgjegjëse (DAP), në përputhje me procedurat e përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ku:
 - ✓ **1 rast**, është emëruar pas përzgjedhjes së trupës së nivelit të lartë drejtues TND,
 - ✓ **4 raste**, janë për pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive,
 - ✓ **2 raste**, janë lëvizje paralele në kategorinë ekzekutive
- **5 pozicione pune**, që zënë rreth **14.7 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë vende të lira (**1 vend i lirë i përket pozicionit, “Zv.drejtor i Përgjithshëm/Drejtor”, 1 vend i lirë i përket pozicionit, “Drejtor”, 1 vend i lirë i përket pozicionit, “Përgjegjës Sektori” dhe 2 vendetë lira i përkasin pozicionit, “Specialist”**).

Të dhënat e mbledhura që pasqyrojnë procedurën e marrjes në punë, përfshirë aktin e emërimit dhe aktin e deklaramit/konfirmimit, janë materializuar në Tabelën1, “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për nëpunësit që punojnë në pozicione të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin, Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë”, që është pjesë e këtij raporti.

II. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u verifikua respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës, të përcaktuara me hollësi në Vendimin nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 2, datë 7.4.2014, të Departamentit të

Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”, i cili është shfuqizuar me Udhëzimin nr.1, datë 31.5.2017, të DAP, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

Këto akte nënligjore, të cilat kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në përmbajtjen e tyre, kanë përcaktuar rastet kur një institucion pjesë e shërbimit civil, duhet të hartojë përshkrimet e punës, procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen gjatë procesit të hartimit të përshkrimeve të punës për pozicionet e shërbimit civil, nëpunësit dhe strukturat përgjegjëse për hartimin e tyre, si dhe organin që ka kompetencën për të bërë miratimin e tyre, dhe po ashtu, vazhdimësinë e procesit, me depozitimin e tyre pranë Departamentit të Administratës Publike si njësi përgjegjëse për Drejtorinë Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë

Në rastin konkret, përshkrimet e punës për Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, duke qenë njësi organizative brenda strukturës së ministrisë, kanë qenë objekt i verifikimit nga Komisioneri, në momentin e monitorimit të procesit të ristrukturimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Më pas, me ndryshimet strukturore të institucionit, të kryera në bazë të vendimit nr.299, datë 23.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë” dhe Urdhrit nr. 88, datë 13.6.2018, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë”, njësia e burimeve njerëzore, në zbatim të pikës 14, Kreu IV, të VKM nr. 142, datë 12.03.2014, të ndryshuar, si dhe të pikës 4.1 të Udhëzimit nr. 1, datë 31.5.2017, të DAP, ku shprehimisht thuhet se, përshkrimet e punës hartohen kur, ***ndryshon mënyra e organizimit të institucionit***, ka hartuar përshkrimet e reja të punës në bazë të riorganizimit të pozicioneve të punës.

Duke vijuar me verifikimin e mëtejshëm të tyre, konstatojmë se, *përshkrimet e punës, janë miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë së linjës*, i cili është një detyrim specifik i parashikuar në pikën 18, shkronja “c”, të VKM nr. 142, datë 12.3.2014, i ndryshuar.

Gjithashtu, janë nënshkruar nga nëpunësi civil, për të cilin është hartuar përshkrimi i punës dhe nga eprorit direkt, në zbatim të pikës 4.2.10, të Udhëzimit nr. 1, datë 31.5.2017, të Departamentit të Administratës Publike “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të

punës në shërbimin civil”, duke pranuar në këtë mënyrë njohjen dhe dakordësinë e këtij dokumenti.

Një kopje e këtij formulari, është pjesë e dosjes individuale të nëpunësit civil dhe me shkresën nr. 6515 prot., datë 12.4.2019, janë depozituar në Departamentin e Administratës Publike.

Në lidhje me përmbushjen e kërkesave të vendit të punës, nga përmbajtja e aktit të përshkrimit të punës, konstatohet se, në ndarjen “*Kërkesa të posaçme*”, janë përcaktuar kërkesat specifike të vendit të punës në lidhje me nivelin e edukimit dhe fushën kryesore të studimeve; përvojën në punë e përcaktuar në terma kohorë; si dhe njohuritë e përgjithshme dhe specifike që nevojiten për përmbushjen e detyrave të pozicionit të punës.

Nga të dhënat e administruara, të cilat pasqyrohen në tabelën nr. 2 : “*Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin, Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë*”, bashkëlidhur raportit, rezulton se, nëpunësit i plotësojnë këto kërkesa.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, Komisioneri, vlerëson punën e njësisë së burimeve njerëzore dhe strukturave të tjera përgjegjëse të institucionit, në lidhje me hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës, sipas përcaktimeve ligjore në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 1, datë 31.5.2017, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”, si dhe përmbylljen e procesit me depozitimin ekëtij dokumenti pranë Departamentit të Administratës Publike.

III. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.

Administrimi i shërbimit civil për të gjithë institucionet e administratës shtetërore bazohet në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, në zbatim në pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”.

Në rastin konkret, në lidhje me nevojat për rekrutim në shërbimin civil për këtë institucion, për vitin 2019, është komunikuar në mënyrë elektronike me Departamentin e Administratës Publike.

Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, u konstatua se institucioni ka 5 pozicione të lira. Rezulton se 1 pozicion i nivelit të mesëm drejtues dhe 1 pozicion i nivelit ekzekutiv, janë planifikuar që prej vitit 2018 dhe vazhdojnë të jenë të lira, ndërsa 3 pozicione, janë krijuar si pasojë e dorëhejeve dhe pezullimit të kërkuara nga nëpunësit në fillim të vitit 2019.

Konkretisht, pozicionet e lira janë:

- 2 pozicione pune, “*Drejtor*”, niveli i mesëm drejtues;
- 1 pozicion pune, “*Përgjegjës Sektori*”, niveli i ulët drejtues;
- 2 pozicione, “*Specialist*”, niveli ekzekutiv.

Evidentojmë faktin se, në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, këto pozicione pune, vazhdojnë të jenë të lira, por të shpallura nga njësia përgjegjëse.

Konkluzion: Në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, Komisioneri, vlerëson se, nga ana e institucionit, janë respektuar kërkesat e ligjit, gjatë procesit të planifikimit të nevojave për konkurrim.

IV. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, u verifikuan emërimet në pozicionet e shërbimit civil nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, të kryera për këtë institucion, pas përfundimit të procesit të ristukturimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, datë 4.12.2017, deri në momentin e mbikëqyrjes.

Në subjektin e mbikëqyrur, u konstatua 1 rast, të emërimit në përfundim të procedurës së përzgjedhjes së anëtarit të trupës së nivelit të larë drejtues, 5 raste, të emërimit nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil dhe 2 raste, të emërimit nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, të parashikuar në nenet 22 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe 1 rast, të emërimit nëpërmjet procedurës së ngritjes në

detyrë në kategorinë e ulët drejtuese, të parashikuar në nenin 26 të ligjit të sipërcituar dhe vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulëtdhe të mesme drejtuese”, të cilat janë kryer nga njësia përgjegjëse, që në këtë rast është Departamenti i Administratës Publike.

➤ *Emërim në pozicion të nivelit të lartë drejtues, TND.*

Bëhet fjalë për nëpunësen *****, anëtar i trupës së nivelit të lartë drejtues, e cila, me aktin nr. 1258 prot., datë 1.2.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, përzgjidhet për pozicionin e punës, Drejtor i Përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë.

Departamenti i Administratës Publike, më pas, me aktin nr. 449/1, datë 23.1.2018, e ka emëruar nëpunësen *E.Kokthi*, në pozicionin e nivelit të lartë drejtues, Drejtor i Përgjithshëm, në këtë institucionin.

➤ *Procedura pranimit në shërbimin civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, në kategorinë ekzekutive.*

Bëhet fjalë për punonjësit:

- ✓ *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, “*Specialist*”, në Sektorin e Përgatitjes dhe Zbatimit të Projekteve, me aktin nr.8618/4, datë 24.12.2018, të Departamentit të Administratës Publike.
- ✓ *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, “*Specialist*”, në Sektorin e Përgatitjes dhe Zbatimit të Projekteve, me aktin nr.888, datë 7.2.2019, të Departamentit të Administratës Publike.
- ✓ *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, “*Specialist*”, në Sektorin e Sigurimit të Cilësisë dhe Kontrollit, me aktin nr. 882, datë 7.2.2019, të Departamentit të Administratës Publike.
- ✓ *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, “*Specialist*”, në Sektorin e Sigurimit të Cilësisë dhe Kontrollit, me aktin nr. 887, datë 7.2.2019, të Departamentit të Administratës Publike.
- ✓ *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, “*Specialist*”, në Sektorin e Menaxhimit të Prokurimeve, me aktin nr. 790, datë 4.2.2019, të Departamentit të Administratës Publike.

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, nëpunësit e emëruar rishtas në shërbimin civil, vazhdojnë periudhën e provës.

➤ *Procedura lëvizje paralele në kategorinë ekzekutive*

Bëhet fjalë për punonjësit:

- ✓ *****, emëruar nëpunës civil në pozicionin, “*Specialist*”, në Sektorin e Menaxhimit të Prokurimeve, me aktin nr. 100, datë 7.1.2019, të Departamentit të Administratës Publike.
- ✓ *****, emëruar nëpunës civil në pozicionin , “*Specialist*”, në Sektorin e Vlerësimit dhe Kontraktimit, me aktin nr. 181, datë 9.1.2019, të Departamentit të Administratës Publike. Në momentin e mbikëqyrjes, ky nëpunës ka dhënë dorëheqjen nga pozicioni i punës.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, Komisioneri vlerëson se procedurat e rekrutimit:emërim nëpozicion të nivelit të lartë drejtues, pranim në shërbimin civil, nëpërmjet konkurrimit të hapur, lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë,janë kryer nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

V. Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Në institucionin e mbikëqyrur, nuk u konstatuan emërim në kundërshtim me ligjin nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Të gjitha procedurat e rekrutimit janë kryer nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike.

IV. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës.

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes në institucion, rezulton se punonjësit e emëruar rishtas, nëpërmjet procedurës konkurruese pranim në shërbimin civil, vazhdojnë periudhën e provës.

VI. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit)

Gjatë procesit të mbikëqyrjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, u konstatua se, është zbatuar vetëm transferimi për shkak të ristrukturimit të institucionit, i parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në lidhje me institutet e ligjit që kanë të bëjnë me transferimin e përkohshëm dhe transferimin e përhershëm, të parashikuar nga nenet 48 dhe 49 të ligjit, për periudhën e mbikëqyrur rezulton se, nuk janë aplikuar procedura të tilla.

a. Transferime për shkak të ristrukturimit të institucionit

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, u konstatua se, institucioni, që nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, deri në Maj të vitit 2018, ka qenë njësi organizative brenda strukturës së Ministrisë së Financave, më pas Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe për pasojë, i është nënshtruar procesit të ristrukturimit bashkë me ministrinë, proces ky i monitoruar nga Komisioneri.

Me vendimin nr. 299, datë 23.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë”, është miratuar funksionimi si institucion në varësi të ministrit përgjegjës për financat. Në zbatim të këtij vendimi, me Urdhrin nr. 88, datë 13.6.2018, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë”, është miratuar struktura aktuale e institucionit.

Nisur nga ky fakt, theksojmë se institucioni ka hyrë në proces ristrukturimi dhe në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u verifikua respektimi i kërkesave që parashikon ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në lidhje me procesin e ristrukturimit, si dhe procedurën e ndjekur në këtë rast.

Nga ky verifikim, rezulton se, siç e kemi thënë edhe në hyrje të materialit, *struktura e re* e miratuar, ka sjellë ndryshime në mënyrën e organizimit tënjësive organizative, (drejtori dhe sektorë), por nuk ka ndryshuar numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil dhe misionin e institucionit. Kjo do të thotë se, institucioni, është përfshirë në një proces riorganizimi që është një nga arsytet që duhet të përmbushet në një proces ristrukturimi.

Në rastin konkret, Drejtoria ePërgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, para ristrukturimit ka funksionuar me 2 drejtori dhe 7 sektorë që janë:

- Drejtoria e Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, (24 pozicione), e cila ka në përbërjen e saj pesë sektorë: Sektori i Menaxhimit të Prokurimeve (6); Sektori i Menaxhimi të Kontratave (4); Sektori i Menaxhimit Financiar (6); Sektori i Kontrollit (3); Sektori i Sigurimit të Cilësisë (4).
- Drejtoria për Zbatimin e Projekteve të BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, (9 pozicione), e cila ka në përbërje të saj dy sektorë: Sektori i Menaxhimit të Prokurimeve (5); Sektori i Menaxhimit Financiar (3).

Pas ristrukturimit, struktura e institucionit paraqitet përsëri me 2 drejtori dhe 7 sektorë që janë:

- Drejtoria për Menaxhimin e Projekteve IPA, (24 pozicione), e cila ka në përbërjen e saj pesë sektorë: Sektori i Përgatitjes dhe Zbatimit të Projekteve (7); Sektori i Vlerësimit dhe Kontraktimit (4); Sektori i Menaxhimit Financiar (4); Sektori i Kontrollit të Nivelit të Parë (FLC) (3); si dhe Sektori i Sigurimit të Cilësisë dhe Kontrollit (5).
- Drejtoria për Zbatimin e Projekteve të Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë (9 pozicione), e cila ka në përbërjen e saj dy sektorë: Sektori i Menaxhimit të Prokurimeve (5) dhe Sektori i Menaxhimit Financiar (3).

Konstatohet se këto njësi organizative janë riorganizuar duke bërë një rishpërndarje të burimeve njerëzore dhe ripozicionimin e nëpunësve civilë në pozicione pune brenda institucionit.

Procesi i ristrukturimit, në përmbajtje të tij, përbëhet nga të gjitha aktet administrative që realizon njësia përgjegjëse gjatë implementimit të tij, që, në rastin konkret, janë aktet e krijimit dhe të funksionimit të Komisionit të Ristrukturimit; aktet e transferimit të nëpunësve që u është ristrukturuar pozicioni i punës; si dhe aktet e riemërimit të nëpunësve pas ristrukturimit.

Në këtë proces, ka luajtur rolin e tij edhe Departamenti i Administratës Publike, si njësia përgjegjëse, në bashkëpunim me institucionin e mbikëqyrur si dhe me Ministrinë e

Financave dhe Ekonomisë, në përmbushje të kërkesave të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore që aplikohen në një rast të tillë.

Nga përmbajtja e dispozitave ligjore që rregullojnë këtë institut të ligjit, rezulton se, njësia përgjegjëse, (që në rastin konkret është DAP), është struktura që krijon Komisionin e Ristrukturimit dhe pas propozimit të bërë prej këtij mekanizmi, ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për sistemimin e çdo nëpunësi civil në vendet e reja të krijuara, të ristrukturuara apo të mbetura si pasojë e ristrukturimit.

Në rastin konkret, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil në institucion, menjëherë pas miratimit të strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, (institucioni i mbikëqyrur), me aktin nr. 9501/4 prot., datë 22.6.2018, “Kërkesë për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit”, i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike, që të krijojë Komisionin e Ristrukturimit për arsye të ristrukturimit në këtë institucion.

Në përgjigje të kësaj shkrese, në përmbushje të kërkesave të pikës 3, të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pikave 16 dhe 17 të Kreut II, të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, si dhe pikës 1/1, 2 dhe shkronja a, të Kreut II, “Krijimi dhe funksionimi i Komisionit të Ristrukturimit”, të Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, njësia përgjegjëse (DAP), me Urdhrin nr. 68, datë 4.7.2018, “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, ka urdhëruar krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, i cili përbëhet nga:

1. Përfaqësuesi i Departamentit të Administratës Publike - në cilësinë e kryetarit,
2. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (si nëpunësi më i lartë civil i institucionit) - në cilësinë e anëtarit,
3. Drejtori i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë - në cilësinë e anëtarit.

Komisioni i Ristrukturimit, ka marrë në shqyrtim dokumentacionin e 24 nëpunësve civilë të institucionit, pasi 9 pozicione pune ishin të lira dhe 1 pozicion pune ishte nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues TND (Drejtore i Përgjithshëm).

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pozicioneve të punës, duke u bazuar në përputhshmërinë e kriterëve të veçanta të pozicioneve të lira me të dhënat e nëpunësve të prekur nga ristrukturimi, me aktin nr. 9501/6 prot., datë 5.11.2018, “Vendim i Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në kuadër të ristrukturimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë”, Komisioni i Ristrukturimit, i ka propozuar njësisë përgjegjëse (DAP), transferimin në 24 raste, të nëpunësve civilë në pozicione, të cilat janë riorganizuar për shkak të ristrukturimit.

Departamenti i Administratës Publike, pasi ka marrë në shqyrtim propozimet e bëra nga Komisioni i Ristrukturimit, me shkresën nr. 7807/1 prot., datë 2.11.2018, ka vendosur transferimin e nëpunësve civilë për shkak të ristrukturimit për të gjitha rastet e propozuara. Konstatohet se për 24 rastet, nëpunësit civilë, janë transferuar në të njëjtin nivel të klasifikimit në shërbimin civil dhe të njëjtin kategori si para ristrukturimit.

Konkretisht:

- 1 rast, nëpunës civil i nivelit të mesëmdrejtues, (zv.drejtor i përgjithshëm/drejtor drejtorie);
- 6 raste, nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, (përgjegjës sektori);
- 17 raste, nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv, (specialist).

Për të gjitha rastet e transferimit, ashtu siç përcaktohet në pikën 20, Kreu II, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, është administruar mendimi me shkrim për pranimin, ose refuzimin e pozicionit të ofruar dhe më pas kanë dalë aktet nominale për secilin nëpunës.

Për nëpunësen ***** me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i institucionit, nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues, TND, konstatohet se, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e eprorit direkt, bazuar të nenin 30 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, si dhe në pikat 3,4,5, të Kreut VII, të Vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, të ndryshuar, ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike, lirimin nga pozicioni i rregullt drejtues, Drejtor i Përgjithshëm dhe emërimin në pozicionin e rregullt drejtues, Drejtor i Përgjithshëm, në kuadër të ristrukturimit të institucionit.

Departamenti i Administratës Publike, po mbi këtë bazë ligjore, me aktin nr. 7807/27, datë 13.11.2018, ka liruar dhe më pas ka emëruar këtë nëpunëse në një pozicion të rregullt drejtues, TND, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë.

Vërejmë se, procesi i ristrukturimit, është shoqëruar edhe me hartimin e përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil, sipas parashikimeve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe mbi bazën e këtyre akteve, është kryer procesi i risistemimit të punonjësve në vendet e riorganizuara.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, Komisioneri vlerëson se, procesi i ristrukturimit në institucionin e mbikëqyrur, është kryer në përputhje me kërkesat e akteve ligjore e nënligjore, që parashikohen gjatë ristrukturimit të institucionit.

VII. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, konstatohen **4 raste** pezullimi nga shërbimi civil me kërkesë të vetë nëpunësit, konkretisht:

1. *****, nëpunëse civile në pozicionin, “Përgjegjëse sektori”, në Sektorin e Menaxhimit të Prokurimeve, në Drejtorinë për Zbatimin e Projekteve të Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë, ka kërkuar pezullimin nga shërbimi civil, për arsye personale, për një periudhë 2 vjeçare.
2. *****, nëpunëse civile në pozicionin, “Specialiste”, në Sektorin e Menaxhimit të Kontratave, ka kërkuar pezullimin nga shërbimi civil, për arsye personale, për një periudhë 2 vjeçare (*pezullim i kryer para se Komisioni i Ristrukturimit të shprehej për sistemimin e kësaj nëpunëseje*).
3. *****, nëpunës civil në pozicionin, “Specialist”, në Sektorin e Kontrollit, ka kërkuar pezullimin nga shërbimi civil, për arsye personale, për një periudhë 2 vjeçare (*pezullim i kryer para se Komisioni i Ristrukturimit të shprehej për sistemimin e këtij nëpunësi*).
4. *****, nëpunës civil në pozicionin, “Specialist”, në Sektorin e Menaxhimit të Prokurimeve, ka kërkuar pezullimin nga shërbimi civil, për arsye personale, për një periudhë 2 vjeçare (*pezullim i kryer para se Komisioni i Ristrukturimit të shprehej për sistemimin e këtij nëpunësi*).

Në zbatim të pikave 10, shkronja “b” dhe 12, shkronja “c”, të Vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*”, nëpunësit, kanë përdorur si shkak të ligjshëm, punësimin në njëpozicion pune të administratës publike, që nuk është pjesë e fushës së veprimit të legjislacionit të nëpunësit civil, duke paraqitur edhe kontratën individuale të punës të lidhur me titullarin e institucionit në cilësinë e punëdhënësit, si dhe për periudhën e studimit jashtë vendit.

Struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, pasi ka marrë dijeni për shkakun e pezullimit dhe ka konstatuar ligjshmërinë e tij, me aktin nr.4666/1 prot., datë 28.3.2019, për nëpunësen Alma Uku; aktin nr. 17709 prot., datë 3.10.2018, për nëpunësen Olsa Dërmishi; aktin nr. 10146 prot., datë 24.5.2018, për nëpunësin Gentian Ramku; dhe aktin nr. 15773 prot., datë 31.8.2018, për nëpunësin Bledar Çela, ka vendosur pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil për këta nëpunës, për një afat kohor 2 vjet, duke njoftuar edhe Departamentin e Administratës Publike, si njësi përgjegjëse, për këto vendimmarrje.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, për rastet e pezullimit nga shërbimi civil, struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, ka vepruar sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*”.

VIII. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore

(kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të Përhershëm të Disiplinës, etj.)

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, u verifikuanëse ka patur procedura administrative disiplinore të realizuara nga institucioni përgjatë periudhës objekt mbikëqyrje dhe rezultoi se për këtë periudhë, nuk ka patur asnjë rast procedimi disiplinor.

IX. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u verifikua procedura e ndjekur nga institucioni për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë për vitin 2018, në përputhje me kërkesat e nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe Vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, ndryshuar me Vendimin nr. 252, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 109, datë*

26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë””.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë të konfirmuar, është një proces që duhet të realizohet çdo 6 muaj, ndërsa për nëpunësit civilë në periudhë prove, periudha e vlerësimit është vjetore dhe llogaritet nga data e emërimit të tij.

Për realizimin e një vlerësimi sa më objektiv, në Vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, të ndryshuar, është përcaktuar dhe procedura që duhet të respektohet për procesin e vlerësimit të rezultateve në punë si dhe kompetencat për vlerësimin. Gjithashtu, pjesë e këtij vendimi, është edhe formulari i vlerësimit të punës, i miratuar për nëpunësit civilë.

Gjatë procesit të verifikimit në institucionin e mbikëqyrur, u konstatua se, formularët e vlerësimit të punës janë hartuar, sipas formatit të miratuar në Lidhjen nr. 2, pjesë e VKM nr. 109, datë 26.2.2014, e ndryshuar, ku janë materializuar të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale (*ndarja A*); të dhënat për kontekstin e punës ku identifikohen objektivat e institucionit dhe të njësisë organizative ku bën pjesë nëpunësi (*ndarja B*); objektivat dhe matësit e performancës, ku duke mbajtur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objektiv (*ndarja C*); sjellja profesionale, e cila ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer dhe realizimin në kohë, punën në grup e marrëdhëniet me kolegët, kërkesën për këshillim, aftësinë menaxheriale për nëpunësit në pozicionet e nivelit të ulët e të mesëm drejtues (*ndarja Ç*); vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë ku bëhet një vlerësim i përmblodhur i arritjes së objektivave kryesore të punës nga nëpunësit.

Në zbatim të programit të kontrollit, për të gjithë nëpunësit, që, në momentin e mbikëqyrjes, punonin në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, grupi i punës verifikoi vlerësimet e rezultateve në punë për 6 mujorin e dytë të vitit 2018.

Për periudhën e vlerësimit objekt verifikimi, në institucionin e mbikëqyrur, u vërejt se, ka pasur vlerësime të pjesshme, për faktin se institucioni ka hyrë në proces ristrukturimi.

Në të gjitha rastet, konstatohet se, është respektuar afati ligjor i realizimit të këtij vlerësimi, në përputhje me pikën 12, shkronja “c”, Kreu II, i VKM nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar.

Më tej, gjatë verifikimit të formularëve të vlerësimit, grupi i punës konstatoi se procedura e vlerësimit për Drejtorin e Përgjithshëm, nuk ishte përmbyllur.

VKM nr.109, datë 26.02.2014, i ndryshuar, në pikat 4 dhe 5, të Kreut II, ka përcaktuar mënyrën e vlerësimit të anëtarëve të TND. Ndër të tjera, ka përcaktuar se në vlerësimin e nëpunësve anëtarë të TND-së, të emëruar në pozicionet, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme dhe pozicione të barazvlefshëm me të, Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes, mbështetet në vlerësimin e bërë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Në rastin konkret, formulari i vlerësimit për nëpunësen E.Kokthi, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, rezulton të mos i jetë përcjellë njësisë përgjegjëse për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës nga KKP.

Në vazhdim, nga verifikimet e kryera, duke patur parasysh katër nivelet e vlerësimit “shumë mirë”, “mirë”, “kënaqshëm” dhe “jo kënaqshëm”, vlerësimi përfundimtar i tyre, paraqitet si më poshtë:

Tabela 1: *Niveli i vlerësimit për periudhën 11.7.2018 – 18.11.2018*

Niveli i vlerësimit përfundimtar	Qershor – Nëntor 2018			
	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm
Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel	11	11	-	-
Totali			22	

Vërejmë se për këtë periudhë janë vlerësuar gjithsej 22nëpunës civilë;3 nëpunës kanë qenë me leje lindje dhe 9 pozicione ishintë lira.

Tabela 2: *Niveli i vlerësimit për periudhën 19.11.2018 – 31.12.2018*

Niveli i vlerësimit përfundimtar	Nëntor – Dhjetor 2018			
	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm
Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel	15	6	-	-
Totali			21	

Për këtë periudhë janë vlerësuar gjithsej 21 nëpunës civilë;4 nëpunës ishin me leje lindje dhe 9 pozicione pune ishin të lira.

Vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive ose dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që në rastin konkret, për të dyja periudhat e vlerësimit, rezulton në nivelin, “shumëmirë” (1).

Nga ana tjetër, vlerësimi i rezultateve në punë synon përmirësimin e aftësive profesionale të nëpunësit dhe të cilësisë së shërbimit, por, në kushtet kur vlerësimin “shumëmirë”, ose “mirë”, e kanë marrë pjesa më e madhe e nëpunësve civilë të institucionit, kjo mënyrë të vepruari, në këtë rast, krijon mundësinë e humbjes së interesit dhe motivimit të nëpunësve për të kryer punën me një nivel gjithnjë e më të lartë cilësie.

Për këtë arsye, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit, (*Zyrtari raportues/Zyrtari kundërfirmues/Zyrtari autorizues*), duhet që të realizojnë një vlerësim pune sa më objektiv dhe më afër realitetit, duke përdorur të gjithë spektrin e vlerësimeve, nga niveli më i lartë “shumë mirë(1)” edhe atë që përfaqëson nivelet më të ulëta të vlerësimit, të tilla si “kënaqshëm (3)” dhe “jo kënaqshëm (4)”, që përcaktohen në ligj dhe aktin nënligjor.

Përsa i përket rasteve të mosmarrëveshjeve lidhur me nivelet e vlerësimit, nuk konstatohet të ketë pasur raste të tilla.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, Komisioneri, vlerëson se, në lidhje me procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, në përgjithësi, janë respektuar kërkesat e ligjit dhe të akteve nënligjore. Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, është plotësuar me të gjithë elementet, sipas ndarjeve të përcaktuara në të dhe është bërë pjesë e dosjes individuale të nëpunësit civil.

Për nëpunësen E.Kokthi, anëtar të TND-së, institucioni i mbikëqyrur, duhet t’i dërgojë zyrtarisht njësisë përgjegjëse vlerësimin e rezultateve në punë për vazhdimin e procedurave të mëtejshme të parashikuara hollësisht në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultatve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, me qëllim vlerësimin përfundimtar të rezultateve në punë.

Përsa i përket nivelit të vlerësimit, në kushtet kur procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësit civilë, synon të përmirësojë aftësitë profesionale të nëpunësve, si dhe të ndikojë në cilësinë e shërbimit të ofruar prej tyre, nga njësia e burimeve njerëzore, duhet të tregohet kujdes në të ardhmen, që ky proces të realizohet sa më objektiv dhe të mos trajtohet si një formalizëm që duhet kryer.

X. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.

Nga verifikimi i dokumentacionit që lidhet me institutin e lirimit nga shërbimi civil, u konstatua se për periudhën objekt mbikëqyrjeje, në institucionin e kontrolluar, evidentohen 5 raste të kësaj natyre, të cilët sqarohen hollësisht, më poshtë:

- ✓ Në 3 raste, punonjësit janë liruar para se Komisioni i Ristrukturimit të shprehej për sistemimin e tyre, mbi bazën e kërkesës për dorëheqje të paraqitur prej tyre, sipas rregullit të përcaktuar në shkronjën, “dh”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Bëhet fjalë për punonjësit:

- ***** , nëpunëse civile në pozicionin, “Specialiste”, në Sektorin e Menaxhimit të Prokurimeve, në Drejtorinë për Zbatimin e Projekteve të BB-së dhe Donatorëve tjetërë. Marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionin, për këtë punonjëse, janë ndërprerë me aktin nr. 18197 prot., datë 11.10.2018, të Drejtorit të Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve.
- ***** , nëpunës civil në pozicionin, “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Menaxhimit të Kontratave, në Drejtorinë Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE-së. Për këtë rast, marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionin, janë ndërprerë me aktin nr. 17930/1 prot., datë 19.10.2018, të Drejtorit të Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve.
- ***** , nëpunës civil në pozicionin, “Specialist”, në Sektorin e Sigurimit të Cilësisë, në Drejtorinë e Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE-së. Për këtë rast, marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionin, janë ndërprerë me aktin nr. 17804 prot., datë 3.10.2018, të Drejtorit të Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve.
- ✓ Në 2 raste, punonjësit janë liruar, pas ristrukturimit, mbi bazën e kërkesës për dorëheqje të paraqitur prej tyre, sipas rregullit të përcaktuar në shkronjën, “dh”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Bëhet fjalë për punonjësit:

- ******, nëpunëse civile në pozicionin, “*Zv.drejtor i Përgjithshëm/Drejtor*”, i Drejtorisë për Zbatimin e Projekteve të BB-së dhe Donatorëve të tjerë. Marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionin, për këtë punonjëse, janë ndërprerë me aktin nr. 3794/1 prot., datë 11.3.2019, të Drejtorit të Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve.
- ******, nëpunës civil në pozicionin, “*Specialist*”, në Sektorin e Vlerësimit dhe Kontraktimit, në Drejtorinë për Menaxhimin e Projekteve IPA. Për këtë rast, marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionin, janë ndërprerë me aktin nr. 4735/1 prot., datë 28.3.2019, të Drejtorit të Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve.

Konstatohet se për të gjitha rastet e dorëheqjes, është njoftuar Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse, për menaxhimin e shërbimit civil.

Për nëpunësit e dorëhequr, nuk ka përfunduar afati 2 vjeçar, i të drejtës që gëzon nëpunësi për të konkurruar si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

Konkluzion: Komisioneri, vlerëson se, njësi e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, ka vepruar drejt në lidhje me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të lirimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes, në bazë të nenit 66, pika 1, shkronja, “*dh*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

XI. Të tjera

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, u konstatua se, në 2 raste, janë zgjidhur marrëdhëniet e punës me institucionin, pasi nëpunësit kanë konkurruar për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë.

Konkretisht:

1. ******, me detyrë Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Prokurimeve, me aktin nr. 9971/2, datë 29.5.2018, të Drejtorit të Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, lirohet nga detyra me arsyen e ngritjes në detyrë në një pozicion tjetër të shërbimit civil.
2. ******, me detyrë Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Prokurimeve, me aktin nr. 15562/1, datë 19.9.2018, të Drejtorit të Drejtorisë së

Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, lirohet nga detyra me arsyen e lëvizjes paralele në një pozicion tjetër të shërbimit civil.

Për të dy rastet, institucioni ka njoftuar zyrtarisht njësinë përgjegjëse, DAP.

XII. Dosjet e personelit

a. Dosja e personelit

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u këqyrën dosjet e personelit, për të verifikuar nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe kërkesave të Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”.

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, u konstatua se, në dosjet personale të nëpunësve, administrohen dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (*fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave, dëshmia e njohjes së diplomës nga institucioni përkatës për studimet e kryera jashtë vendit*); dokumentet që vërtetojnë fillimin e marrëdhënieve të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*). Për sa i takon vërtetimit të gjendjes shëndetësore (*Raporti Mjekësor*), si dhe vërtetimit të gjendjes gjyqësore, u konstatuan mungesa.

Sjellim në vëmendje të institucionit se, vërtetimi i gjendjes shëndetësore, duhet të paraqitet pranë burimeve njerëzore të institucionit, brenda datës 10 janar të çdo viti, parashikuar në pikën 23, Kreu III, “*Lirimi nga shërbimi civil*”, të Vendimit nr. 124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*”.

Në mënyrë të hollësishme këto akte janë materializuar në Tabelën 2, “*Respektimi i kërkesave të përgjithshme, sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për punonjësit që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në institucionin, Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë*”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nga grumbullimi i të dhënave konstatohet se, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, në momentin e mbikëqyrjes ka gjithsej **34 pozicione pune pjesë e shërbimit civil**, nga të cilat:

- 29 pozicione pune janë të plotësuar;
- 5 pozicione pune janë të lira ose 14.7%
 - ✓ 25 nëpunës civilë janë të gjinisë femërore, ose 73.5%;
 - ✓ 4 nëpunës civilë janë të gjinisë mashkullore, ose 11.8%;
 - Moshë mesatare për femrat është rreth 33.3 vjeç,
 - Moshë mesatare për meshkujt është rreth 33.8 vjeç,
 - Moshë mesatare në total është rreth 33.6 vjeç.

Për sa i përket arsimit të nëpunësve pranë këtij institucioni, rezultojnë si më poshtë:

- 24 nëpunës zotërojnë diplomë të arsimit të lartë në institucione arsimore publike;
- 3 nëpunës zotërojnë diplomë të arsimit të lartë në institucione arsimore private;
- 2 nëpunës zotërojnë diplomë të marrë në universitete të huaja, të njësuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Konkluzion: Sa më sipër, vlerësohet se, dosjet e personelit janë pothuajse të rregullta dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen në Sektorin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, që është edhe njësia përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore për institucionin.

Njësia përgjegjëse e institucionit, duhet të plotësojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, me dokumentet e evidentuara në mungesë, të pasqyruara në tabelën 2, e cila është pjesë e raportit.

b. Regjistri i personelit

Regjistri Qendror i Personelit, si sistemi që ruan dhe përpunon të dhënat elektronike për burimet njerëzore aktive në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, është krijuar dhe administrohet nga Departamenti i Administratës Publike. Institucioni i mbikëqyrur, ka akses në sistem dhe e ushtron këtë funksion nëpërmjet nëpunësit të autorizuar. Në sistem bëhet plotësimi dhe përditësimi i të dhënave të parashikuara në lidhjen 3, “Përkufizimi i administruesve dhe përdoruesve të sistemit”, që i bashkëlidhet Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit të personelit”.

*
* * *

Këto ishin rrethanat e konstatuara nga grupi i punës gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Aktet administrative që dokumentojnë procesin e mbikëqyrjes në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat si më poshtë:

Tabela 1 “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punojnë në pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë”

Tabela 2 “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë”.

K O M I S I O N E R I

Pranvera STRAKOSHA